



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Rishikimi i tarifave të energjisë elektrike 2008

RAPORT KONSULTATIV

DEKLARATË

Ky raport konsultativ është përgatitur nga ZRRE në mënyrë që të pranojë komente dhe mendime nga palët e interesuara. Ky dokument nuk duhet të konsiderohet se paraqet një vendim të ZRRE-së.

Prishtinë, 10 Mars 2008

Përmbajtja

Përmbajtja

Përmbajtja	i
Përmbledhje	ii
Hyrje	ii
Të hyrat e lejuara	ii
Tarifat me pakicë	iii
1 HYRJE	1
2 Procesi i rishikimit	2
3 Kërkesa e të hyrave të lejuara-Përmbledhje	3
4 Kërkesa për të hyra të lejuara - KEK	6
4.1 Shpenzimet Kapitale të pafinancuara	6
4.2 Humbjet e distribucionit	6
5 Kërkesa e të hyrave të lejuara – KOSTT	8
5.1 Kompensimi për pagesën e humbjeve të 2007ës.	8
5.2 Shpenzimet kapitale të pafinancuara	8
5.3 Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit	9
6 Kërkesë për të hyrat e lejuara-propozimet	10
7 Tarifat me pakicë të kërkuara nga KEK-u	11
8 Shqyrtimi i tarifave të kërkuara	13
9 Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRRE	14
10 Pagesat e kërkuara të transmisionit	16

Përmbledhje

Hyrje

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është aktualisht duke bërë një rishikim të tarifave të me pakicë të energjisë elektrike që do të aplikohen nga KEK Sh.A dhe tarifave të transmisionit që aplikohen nga KOSTT Sh.A¹ që nga 1 prilli 2008. Ky raport konsultativ është publikuar si një mundësi për palët e interesuara që të paraqesin komentet e tyre për këto aplikime para se ZRRE të lëshojë vendim mbi tarifave të aprovuara. **Deri më tani ZRRE nuk ka marrë asnjë vendim mbi tarifave që do të aprovohen. Propozimet nga ZRRE janë preliminare dhe ofrohen vetëm si baze për tu komentuar nga palët e interesuara.**

Afati i fundit për pranimin e komenteve mbi këtë Raport konsultativ është 20 Marsi 2008. Tarifave të reja të aprovuara do të hyjnë në fuqi prej 1 prillit 2008.

Aplikacionet preliminare të tarifave janë paraqitur nga KEK-u dhe KOSTT-i në Dhjetor 2007. ZRRE ka bërë një analizë të thukët të këtyre aplikacioneve. Aty janë përfshirë gabimet në të dhëna, mospërputhshmëritë, si dhe një vlerësim i arsyeshmërisë së koston të propozuar dhe kërkesave për justifikimin ose përmirësimin e tyre. Si rezultat i një analize të tillë, KEK-u dhe KOSTT-i kanë bërë mjaft përshtatje aplikacioneve të tyre fillestare. Aplikacionet e prezantuara në këtë raport konsultativ janë aplikacionet e përmirësuara pas kompletimit të atyre përshtatjeve.

Të hyrat e lejuara

Te hyrat e kërkuara për industrinë në përgjithësi për 2008 janë përafërsisht 13% më të mëdha se nivelet e lejuara në 2007-tën. Kostoja e kërkuar e blerjes së energjisë rritet për 18%, kostoja tjetër e kërkuar nga KEK-u për 10%, si dhe kostoja për KOSTT-in (përfshirë humbjet e transmisionit) për 16%.

Subvencionet e importit dhe të hyrat nga eksporti i energjisë elektrike si dhe shitjet konsumatorëve të privilegjuar janë zbritur nga ato të hyra të kërkuara për të përcaktuar të hyrat e lejuara që të mbulohen nga konsumatorët e rregulluar. Rritjet e mëdha në subvencionet e importit (prej 10 milion euro parashikimi i vitit 2007) dhe shitjet konsumatorëve të privilegjuar janë projektuar për 2008. Si rezultat, të hyrat e kërkuara të mbulohen nga konsumatorët e rregulluar janë në parim të pandryshuara nga nivelet e lejuara të 2007-tës. Volumet e parashikuara të shitjes konsumatorëve të rregulluar janë 15% mbi shitjet aktuale të 2007-tës.

Kostoja e kërkuar mesatare rezultuese për njësi duhet të rimerret nga konsumatorët e rregulluar gjatë 2008-tës dhe është €5.51/kWh, 10% mbi koston mesatare të lejuar për njësi gjatë 2007-ës.

ZRRE propozon që të bëhet një numër i përmirësimeve në të hyrat e lejuara siç kërkohet nga KEK-u dhe KOSTT-i. Këto përfshijnë:

- Moslejimin e shpenzimeve kapitale për të cilat nuk janë zotuar fondet (ose nga BKK ose nga burimet tjera). Kjo përfshinë moslejimin e të gjitha shpenzimeve të kërkuara kapitale të lidhura me Drejtorinë Qendrore të KEK-ut dhe divizionin e furnizimit.

¹ Operatori i pavarur i transmisionit dhe tregut i Kosovës (KOSTT)

Përmbledhje

- Zvogëlimin e humbjeve të lejuara jo-teknike të distribucionit (shumica për shkak të vjedhjes dhe gabimeve në të dhëna) nga 22% sa janë regjistruar gjatë 2007-tës në 20% dhe me zvogëlime të pritura edhe në të ardhmen.

Rezultati është që të reduktohet kostoja mesatare e kërkuar për njësi dhe ti ngarkohet konsumatorëve të rregulluar në 2008 në €c5.27/kWh, 5.3% mbi nivelin e aprovuar për 2007.

Tarifat me pakicë

KEK-u ka propozuar disa ndryshime në strukturën e tarifave me pakicë. Këtu përfshihen:

- Rritja e tarifave/taksave fikse të konsumatorëve për konsumatorët më të mëdhenj të cilët kushtojnë më shumë për t'u shërbyer.
- Eliminimi i tarifave ditë/natë aktuale për konsumatorët shtëpiakë dhe konsumatorët e vegjël komercialë si dhe aplikimi i tarifave një-normëshe për çdo sezone. KEK-u thotë se njëhisorët aktualë nuk janë në gjendje që saktësisht të regjistrojnë kohën e konsumit.
- Eliminimin e blok-tarifave rritëse për konsumatorët shtëpiakë dhe aplikimi i tarifave të njëjta për gjithë konsumin. KEK-u thotë që konsumatorët në nevojë mund të ndihmohen përmes tarifës së re për të cilët konsumatorët do të duhet të dëshmojnë privilegjetin e tyre.

ZRRE propozon që të pranojë rritjen e taksave fikse për konsumatorët më të mëdhenj por nuk propozon që të pranojë eliminimin e tarifave ditore ose të bllok tarifës rritëse. ZRRE konsideron që këto janë të rëndësishme për të siguruar mundësinë paguese dhe promovimin e përdorimit efektiv të energjisë. Tarifat e kërkuara nga KEK-u do të rezultojnë në rritjen e pagesave të energjisë për konsumatorët më të vegjël shtëpiakë në nivele që janë të papranueshme.

Rrjedhimisht, ZRRE propozon që tarifat të rriten për 5%. Gjithashtu janë propozuar rritje në tarifat fikse për konsumatorët më të mëdhenj dhe në tarifat energjisë reaktive për konsumatorët më të mëdhenj industrialë dhe komercialë.

1 HYRJE

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) është aktualisht duke bërë një rishikim të tarifave me pakicë të energjisë elektrike për tu aplikuar nga KEK Sh.A. dhe taksave të transmisionit të aplikuara nga KOSTT-I SH.A.² nga 1 Prilli 2008. Ky rishikim përmban nivelin e të hyrave të lejuara për tu mbuluar nga KEK-u dhe KOSTT-I në 2008 nga tarifat e rregulluara dhe ngarkesat si dhe strukturën e këtyre tarifave dhe ngarkesave.

Ky raport konsultativ është publikuar për t'u dhënë rast palëve të interesuara që të ofrojnë komentet mbi këto aplikime, para se ZRRE të marrë vendim mbi tarifat e aprovuara. Këtu përfshihen:

- Një përshkrim i procesit të rishikimit deri në ditën e sotme
- Pikëpamjet e ZRRE-së mbi të hyrat e lejuara për 2008 të kërkuara nga KEK-u dhe KOSTT-I si dhe propozimet preliminare lidhur me nivelin e arsyeshëm të të hyrave të lejuara për tu mbuluar nga tarifat e rregulluara.
- Një përmbledhje të ndryshimeve të kërkuara mbi strukturën e tarifave me pakicë të paraqitur nga KEK-u³.
- Pikëpamjet e ZRRE-së mbi këto ndryshime të propozuara si dhe propozimet preliminare mbi rishikimet e strukturave tarifore aktuale.
- Tarifat dhe pagesat e aplikuara nga KEK-u dhe KOSTT-i si dhe të atyre që do të mund të aprovohen sipas propozimeve preliminare të ZRRE-së.

Kopjet e tëra të aplikacioneve të pranuar janë në dispozicion në faqen elektronike të ZRRE-së www.ero-ks.org.

Deri me tani, ZRRE nuk ka marrë asnjë vendim mbi tarifat që do të aprovohen. Propozimet e ZRRE-së të paraqitura në këtë shkresë janë vetëm preliminare dhe nënkuptojnë vetëm një bazë për komente nga palët e interesuara. ZRRE do të marrë vendimin e vet mbi tarifat e aprovuara vetëm pas rishikimit dhe shqyrtimit të të gjitha komenteve dhe pikëpamjeve të paraqitura nga palët e interesuara.

Afati i fundit për pranimin e komenteve mbi këtë Raport konsultativ është 20 Marsi 2008. Tarifat e reja të aprovuara do të hyjnë në fuqi prej 1 prillit 2008.

Komentet duhet të paraqiten me shkrim. Preferohet formati elektronik. Komentet e paraqitura me email duhet të dërgohen në ero.pricing-tariffs@ero-ks.org me paragrafin e theksuar në **lende/subjekt** "ETR 2 Raporti Konsultative – Komentet".

Komentet e shtypura (hard-copy) duhet t'i dërgohen ZRRE-së në zyret që gjenden në rr. Hamdi Mramori , Nr 1, 10000 Prishtinë të adresuara për "Departamentin e Çmimeve dhe Tarifave".

ZRRE planifikon që të publikojë të gjitha komentet e pranuar ose në tërësi ose si përmbledhje. Palët e interesuara duhet të theksojnë ndonjë pjesë të komenteve të tyre që dëshirojnë të trajtohet si konfidenciale.

² Operatori i pavarur i transmisionit dhe tregut i Kosovës (KOSTT)

³ Asnjë ndryshim në strukturën e pagesave të transmisionit nuk është propozuar nga KOSTT-I dhe për këtë arsye edhe nuk janë rishikuar në këtë raport konsultativ.

2 Procesi i rishikimit

Aplikacionet preliminar mbi tarifatat e janë paraqitur nga KEK-u dhe KOSTT-I në Dhjetor 2007. Këto aplikacione paraqesin propozimet e kompanive lidhur me të hyrat e lejuara, ndryshimet në strukturën tarifore si dhe tarifatat rezultuese.

ZRRE ka bërë një analizë të thukët të këtyre aplikacioneve. Kjo analizë ka përfshirë identifikimin e gabimeve të të dhënave dhe paqëndrueshmëritë si dhe një vlerësim të arsyeshmërisë së kostos së propozuar dhe kërkesave për arsyetimin ose ndryshimin e tyre. Si rezultat i një analize të tillë, KEK-u dhe KOSTT-I kanë bërë një numër të rëndësishëm përshtatjesh aplikacioneve fillestare të tyre në mënyrë që te merren në konsideratë vërejtjet e ZRRE-së.

Aplikacionet e prezantuara në këtë raport konsultativ janë aplikacione të përmirësuara që kanë rezultuar pas përfundimit të kësaj analize dhe përgjigjeve të KEK-ut dhe KOSTT-it. Në disa raste, KEK-u dhe KOSTT-I kanë konsideruar se s'ka nevojë për asnjë përmirësim/amendament. Aty ku ZRRE vazhdon të konsiderojë që kërkesat e përfshira në aplikacionet e përmirësuara janë të paarsyeshme dhe të paarsyetueshme atëherë ka përgatitur propozime preliminare mbi korrigjimet e duhura për tu implementuar përmes vendimit të tij mbi tarifatat e aprovuara. Këto propozime preliminare janë prezantuar gjithashtu në këtë Raport Konsultativ.

Duhet të thuhet se ZRRE edhe më tutje ka vështirësi në përshtatjen/barazimin e elementeve të ndryshme të aplikacionit të prezantuar nga KEK-u në veçanti. Në disa raste, vlera ndryshuese për kosto dhe për çështje të të hyrave janë dhënë në aplikacionin formal dhe formatet mbështetëse të detajizuara të të hyrave. Në të tjerat, ZRRE ka marrë vlera rezultuese gjatë inputit/futjes së përmbajtjes së formatit të të dhënave në modelin e tarifave dhe të hyrave të saj (RTM), te ndryshueshme nga ato që janë prezantuar nga KEK-u në aplikacionin e tij që është përpiluar duke përdorur vlerat e njëjta hyrëse dhe modelin e njëjtë. Në raste të tilla, qasja e ZRRE-së ka qenë që të:

- Marrë vlerat hyrëse nga versionet më të reja të formateve të të dhënave të paraqitura nga KEK-u.
- Marrë vlerat dalëse të llogaritura nga RTM i ZRRE-së duke përdorur vlerat hyrëse.

3 Kërkesa e të hyrave të lejuara-Përmbledhje

Një përmbledhje e të hyrave të lejuara kërkuar nga KEK-u dhe KOSTT-I është prezantuar më poshtë në Tabelën 1. Kjo tregon qe, për çdo divizion⁴ te KEK-ut dhe për KOSTT:

- Të hyrat e përgjithshme të aprovuara nga ZRRE
- Koston e përgjithshme gjate 2007-tës sipas të dhënave të ofruara nga KEK-u dhe KOSTT-i
- Të hyrat e përgjithshme të kërkuara nga KEK-u dhe KOSTT-i për 2008.
- Subvencionet e ofruara nga BKK si parashikim për 2007, ne fakt të pranuar për 2007 dhe të aprovuara për 2008.
- Të hyrat nga eksporti i energjisë si parashikim për 2007, në fakt të pranuar për 2007 dhe të pritura për 2008.
- Te hyrat nga shitja e energjisë elektrike konsumatorëve të privilegjuar (Feronikeli) si parashikim për 2007, ne fakt të pranuar për 2007 dhe të pritura për 2008.
- Sasitë e energjisë elektrike (pas lejimit të humbjeve të transmisionit dhe distribucionit) të shitura konsumatorëve të rregulluar (kategorive 0 deri 8), ne fakt të arritur gjatë 2007 dhe të pritura për 2008.
- Kostoja rezultuese mesatare për njësi e furnizimit të konsumatorëve të rregulluar e lejuar për 2007, në fakt e aplikuar në 2007 dhe e kërkuar për 2008.

Kostoja e paraqitur për Distribucionin e KEK-ut dhe KOSTT-it përjashton koston e humbjeve të blera nga entitetet e tjera⁵.

Tabela 1: Të hyrat e kërkuara nga KEK-u dhe KOSTT-i për tu lejuar

		2007	2007	2008
		Të Lejuara	Aktuale	Të kërkuara
Kostoja e blerjes së energjisë a)	000 €	46,316.1	51,090.2	54,632.0
KEK Miniera	000 €	42,150.8	36,873.7	44,277.8
KEK Gjenerimi	000 €	38,047.5	32,791.0	42,329.0
KEK Distribiumi (duke përjashtuar blerjet e humbjeve të energjisë)	000 €	16,843.5	14,272.4	23,366.8
KEK Furnizimi (duke përjashtuar koston e energjisë)	000 €	6,008.9	2,235.2	3,252.8
KOSTT (përjashtuar blerjet e humbjeve të energjisë)	000 €	8,635.3	5,536.0	9,988.8
Gjithsej të ardhurat e lejuara	000 €	158,002.1	142,798.3	177,847.1
Subvencionimet e Importit	000 €	9,872.9	12,915.0	19,800.0
Të hyrat nga Eksporti	000 €	2,765.1	12,804.3	1,461.9
Të hyrat nga shitja për konsumatorët e kualifikuar	000 €	10,329.5	3,400.6	19,692.3
Gjithsej të hyrat e lejuara të mbuluara prej konsumatorëve tarifor	000 €	135,034.6	113,678.4	136,892.9
Shitjet për konsumatorët tarifor	GWh	2,699.7	2,170.2	2,486.5
Kostoja mesatare e rregulluar për njësi	€/kWh	5.00	5.24	5.51

a) Importi + blerja e energjisë nga Ujmani dhe gjeneratorët e lidhur në rrjetin distributiv

⁴ Kostoja e divizionit te drejtorisë qendrore të KEK-ut është alokuar mes divizioneve tjera n mes divizioneve tjera në proporcion me numrin e përgjithshëm të punonjësve.

⁵ Distribucioni i KEK-ut dhe KOSTT-it kërkohet që të kompensojnë furnizimin e KEK-ut për koston e blerjes së energjisë në mënyrë që të plotësojnë humbjet e distribucionit dhe transmisionit në mënyrë përkatëse

Kërkesa e të hyrave të lejuara-Përmbledhje

Të Hyrat e kërkuara për tu lejuar për industrinë si tërësi gjatë 2008-tës janë përafërsisht 13% mbi nivelet e lejuara në 2007. Çmimet e kërkuara të blerjes së energjisë rriten për 18%, kostoja tjetër e kërkuar nga KEK-u për 10% dhe kostoja e kërkuar nga KOSTT-i (përfshirë humbjet e transmisionit) për 16%.

Subvencionet nga importi dhe të hyrat nga eksporti i energjisë si dhe shitja konsumatorëve të privilegjuar janë zbritur nga këto të hyra të lejuara për të përcaktuar të hyrat e lejuara që të mbulojnë nga konsumatorët e rregulluar. Rritje të mëdha në subvencionet e importit (prej 10 milion € nga nivelet e parashikimit të 2007 tës) si dhe shitjet konsumatorëve të privilegjuar janë projektuar për 2008. Këto pritjet të mbulojnë mbi 20% të të hyrave të lejuara të kërkuara duke reduktuar kështu në masë të madhe koston që pasohet përmes tarifave të rregulluara për konsumatorë. Si rezultat, të hyrat e kërkuara që rikthehen nga konsumatorët e rregulluar janë virtualisht të pandryshuara nga nivelet e lejuara të 2007-tës përkundër rritjes në total të të hyrave të lejuara të kërkuara nga KEK-u dhe KOSTT-i.

Sasitë e parashikuara të vëllimit të shitjes për konsumatorët e rregulluar janë përafërsisht 15% mbi shitjen aktuale të 2007 tës.

Kostoja rezultuese mesatare e kërkuar për njësi që duhet të rikthehet nga konsumatorët e rregulluar në 2008 është €5.51/kWh, 10% mbi koston mesatare për njësi të lejuar për 2007.

Duhet të theksohet që krahasimet e koston të lejuar dhe asaj aktuale për 2007 tën në masë të madhe janë çorientuese. Shpenzimet aktuale në disa raste janë kufizuara në nga mungesa e parasë së gatshme (për shkak të normës së ulët të inkasimit). Për këtë arsye duhet të pritjet që shpenzimet aktuale janë nën nivelet e lejuara. Kjo nuk nënkupton që nivelet e lejuara kanë qenë shumë të rritura por që KEK-u nuk ka qenë në gjendje që të inkasojë nivelet e lejuara të shpenzimeve të konsumatorëve.

Si informacion shtesë, Tabela 2, më poshtë, paraqet një analizë të energjisë së furnizuar KEK- ut dhe të shitur siç është lejuar për 2007-tën, në fakt e bërë gjatë 2007 tës dhe e kërkuar për 2008 tën.

Tabela 2: Qarkullimi i energjisë siç kërkohet nga KEK-u dhe KOSTT-i.

		2007	2007	2008
		Të Lejuara	Aktuale	Të kërkuara
Importi	GWh	576.6	642.3	497.0
<i>Kostoja mesatare (importet e kontraktuara)</i>	€/kWh	7.40	8.37	10.40
KEK gjenerimi	GWh	3,942.0	4,239.3	4,407.3
<i>kostoja mesatare (duke përfshirë koston e minierave)</i>	€/kWh	2.03	1.64	1.97
Gjeneratorët e kyçur në transmisionin e Kosovës	GWh	113.0	70.1	76.0
<i>Kostoja mesatare</i>	€/kWh	2.13	2.74	2.40
Gjeneratorët e kyçur në rrjetin e distribucionit	GWh	41.3	23.6	28.0
<i>Kostoja mesatare</i>	€/kWh	3.00	3.97	4.00
Gjithsej furnizimi	GWh	4,672.8	4,975.3	5,008.3
<i>Kostoja mesatare</i>	€/kWh	2.71	2.43	2.82
Humbjet në transmision	GWh	169.9	266.6	196.1
		3.7%	5.4%	3.9%
<i>të cilat, humbjet e transmisionit në tranzit</i>	GWh	-31.0	-3.2	-31.0
Humbjet në Distribucion	GWh	1,382.8	1,941.7	1,560.1
		35.0%	48.1%	40.0%
Konsumi vetanak	GWh	0.0	98.9	100.0
Eksporti	GWh	92.2	378.9	33.0
Shitjet për konsumatorët e kualifikuar (Feronikeli)	GWh	359.2	122.2	663.6
Shitjet për konsumatorët 110 kV	GWh	131.6	76.8	146.3
Shitjet për konsumatorët e lidhur në rrjetin distributiv	GWh	2,568.1	2,093.4	2,340.2
Shitjet totale për konsumatorët tarifor	GWh	2,699.7	2,170.2	2,486.5

Kërkesa e të hyrave të lejuara-Përmbledhje

Siç mund të shihet , rritja e madhe e kostos së blerjes së energjisë në raport me nivelin e lejuar për 2007 është si pasojë në radhë të parë e rritjeve të mëdha në kostot e projektuara të importit. Kjo rritje prej 25% nga niveli aktual i 2007 tës dhe nga rreth 40% të atyre niveleve të projektuara njëkohësisht me përcaktimin e të hyrave të lejuara për 2007. KEK-u ka justifikuar këtë rritje të kërkuar duke ju referuar çmimeve aktuale regjionale te tregut me shumice.

Për të vlerësuar arsyeshmërinë e kësaj rritje të kërkuar në çmimet e importit, ZRRE ka krahasuar çmimet e përgjithshme të energjisë për Janar dhe Shkurt 2008 si dhe Janar dhe Shkurt 2007 në Bursën Evropiane të Energjisë (EEX), e cila cakton çmimet e energjisë në periudha te ndryshme për shumicën e tregut evropian. Për Janar dhe Shkurt 2007,çmimet mesatare ditore kanë qenë €39.9/MWh ⁶. Për janar dhe shkurt 2008 këto janë rritur në €67.0/MWh që është një rritje prej 68%. Përderisa vetëm një vlerësim për çmimet e tregut të energjisë elektrike ndërkombëtarisht të ndryshueshme sugjeron se çmimet e tregut të energjisë elektrike janë rritur në mënyrë thelbësore që nga 2007-a.

⁶ E llogaritur si mesatare e çmimit mesatar për tregun brenda ditor në orët 15.00-16.00 në të gjitha ditët e punës në janar dhe shkurt.

4 Kërkesa për të hyra të lejuara - KEK

Në bazë të pasqyrës së të hyrave të kërkesës së KEK-ut për të hyra të lejuara për 2008-tën, çështjet më brengosëse për ZRRE-në janë supozimet e KEK-ut mbi:

- Shpenzimet kapitale të pafinancuara
- Shpenzimet e distribucionit

Këto çështje janë diskutuar në vijim.

4.1 Shpenzimet Kapitale të pafinancuara

KEK-u ka parashikuar një total prej € 152 milionë në shpenzime kapitale për 2008. Prej këtyre, €50.9 milionë do të duhej të financoheshin nga grantet, €80.4 milion nga huatë prej BKK dhe pjesa tjetër aktualisht është e pafinancuar.

ZRRE shpreh rezervën se ky program i shpenzimeve kapitale është joreal. ZRRE vëren të hyrat e lejuara të aprovuara për 2007 kanë ofruar €109 milion në shpenzime kapitale nga KEK-u por përfundimisht shpenzimet aktuale kanë qenë vetëm €38 milionë.

KEK-u ka shpjeguar se ky dallim në masë të madhe është për shkak të vonësive në prokurim si rezultat i fondeve të pakta. ZRRE vëren që nuk duket e mundshme që kjo situatë të ndryshojë gjatë 2008-tës. Aty ku fondet nuk janë në dispozicion nga BKK ose burimet e donatorëve, KEK-u do të ketë nevojë që këto t'i marrë ose nga rezervat e brendshme të keshit (që për momentin janë shumë të vogla) ose prej huave komerciale (që për momentin shihen si joreale në sasi të rëndësishme).

ZRRE vëren që grantet dhe huat aktuale të vëna në dispozicion nga BKK për 2008-tën gjithsej €38 milionë respektivisht € 79.4 milionë janë më pak se ato të supozuara nga KEK-u.

Megjithatë KEK-u propozon që të përshtatet shpenzimet kapitale të lejuara për 2008 e tutje që të përputhet me shumat e alokuara në grante dhe hua nga BKK. Përrjashtim nga kjo është investimi i propozuar i KEK-ut prej 10 milionëve në njëjësorë distributivë në 2008.

Njëjësorët e rinj janë esencialë për reduktimin e humbjeve joteknike të cilat janë shumë të mëdha për momentin. ZRRE megjithatë konsideron që këto shpenzime duhet të lejohen për 2008-tën edhe pse aktualisht janë të pafinancuara.

ZRRE do të vazhdojë të monitorojë mundësinë e KEK-ut që të ndërmarrë këto shpenzime. Aty ku ato nuk bëhen, ZRRE do të aplikojë një përshtatje të mëturshme korresponduese në të hyrat e lejuara për 2009 duke korigjuar për amortizimin dhe kthimet e lejuara për 2008 në asete që në të vërtetë nuk janë ndërtuar. Një adaptim i ngjashëm është bërë këtë vit për asetet e lejuara por që nuk janë ndërtuar gjatë 2007-tës.

4.2 Humbjet e distribucionit

ZRRE gjithashtu shpreh brengosjen për vazhdimësinë e nivelit të lartë të humbjeve të distribucionit të supozuar të KEK-ut prej 18% për humbjet teknike dhe 22% për ato joteknike.

ZRRE pranon se humbjet e supozuara të distribucionit prej 40% përfaqësojnë një zbritje të rëndësishme në nivelet aktuale të 2006 dhe 2007-ës prej 48%. Megjithatë këto humbje janë të larta në krahasim me nivelet e lejuara të caktuara për 2007, 14% të humbjeve teknike dhe 21% për ato joteknike.

Kërkesa për të hyra të lejuara - KEK

Humbjet teknike janë ato të rezultuara nga karakteristikat e rrjetit (psh. rezistenca në rrjetat e distribucionit). Të gjitha rrjetat do të pësojnë humbje teknike. Norma e humbjeve rritet me, mes faktorëve tjerë, rrjetave më të vjetra dhe të mirëmbajtura dobët, rrjetave me konsumatorë më të shpërndarë dhe rrjetave që punojnë me gati tërë kapacitetin. Mundësia e KEK-ut për ti kontrolluar këto humbje pa ndonjë investim substancial në rrjetat e distribucionit është e kufizuar.

ZRRE prët që këto humbje të zvogëlohen me kohë kur KEK-u të ndërmarrë investime dhe të rrisë shpenzimet e mirëmbajtjes. Megjithatë ZRRE pranon që nivelet ekzistuese të humbjeve teknike do të marrin kohë për tu reduktuar pasi ka nevojë për shpenzime kapitale – të cilat KEK-u nuk është në gjendje t'i financojë.

Humbjet joteknike janë kryesisht të shkaktuara për shkak të vjedhjeve dhe gabimeve të matjes. Këto humbje janë më shumë brenda kontrollit të KEK-ut sesa humbjet teknike dhe mund të reduktohen me shpenzime të limituara . Megjithatë ZRRE nuk e konsideron që është në rregull të lejohen humbjet jo-teknike më të mëdha të KEK-ut sesa janë konsideruar të pranueshme në 2007 dhe KEK-u vërtetë duhet të jetë në gjendje që më tutje t'i reduktojë këto humbje. ZRRE për këtë arsye propozon që të caktohet një cak për humbjet joteknike prej 20% në 2008tën. ZRRE prët reduktime të mëtutjeshme prej 2009tës e tutje kur të vendosen njehsorët e rinj të distribucionit.

ZRRE kështu propozon që të caktohet totali i humbjeve të lejuara të distribucionit për 2008 në 38%, i përbërë prej humbjeve teknike prej 18% dhe atyre joteknike prej 20%. Ky është ekuivalent me rritjen e supozuar të shitjes së energjisë në 2008 prej 78 GWh.

Për t'i ikur dyshimit ZRRE gjithashtu konfirmon që asnjë lehtësim nuk është bërë për të hyrat e faturuara por të painkasuara-psh. Te hyrat e lejuara supozojnë një normë prej 100% të inkasimit. Kostoja e shoqëruar me mungesën e inkasimit barten plotësisht nga KEK-u e jo nga konsumatorët.

5 Kërkesa e të hyrave të lejuara – KOSTT

ZRRE ka tri çështje brengosëse sa i përket të hyrave të lejuara të kërkuara nga KOSTT-it për 2008:

- Kompensimin për pagesën e humbjeve të 2007.
- Shpenzimet kapitale të pafinancuara.
- Kostoja mesatare e peshuar e kapitalit (kthimi i lejuar).

5.1 Kompensimi për pagesën e humbjeve të 2007tës.

Kostoja aktuale e humbjeve të transmisionit e blerë nga KOSTT-i në 2007 ka tejkaluar dispozitat e përfshira në të hyrat e lejuara për 2007. ZRRE ka caktuar në metodologjinë e saj tarifore të publikuar, që KOSTT-i duhet të kompensojë për këtë kosto shtesë të cilat janë jashtë kontrollit të saj. Ky kompensim bëhet përmes një rritjeje në të hyrat e lejuara për 2008.

KOSTT-i në raportet e tij dërguar ZRRE-së ka vlerësuar këto shpenzime shtesë të jenë €0.688 milionë për periudhën Maj –Dhjetor 2007. Ekstrapolimi për tu përputhur me 2008 do të nënkuptonte shpenzime shtesë për humbjet prej €0.946 milion që të përfshihen në të hyrat e lejuara për 2008.

ZRRE konsideron që shifra e ulët për kompensim është e justifikuar. Kërkesa e KOSTT-it për kompensim përfshinë shpenzimet e të gjitha humbjeve shtesë dhe ato të përfshira në të hyrat e lejuara për 2007-pavarësisht prej asaj se a janë ato për shkak të gabimeve në parashikim ose për shkak të pamundësisë së KOSTT-it për të kontrolluar humbjet e transmisionit. Lejimi i KOSTT-it që të rimarr diferencën e plotë do të heq motivin e tij për të kontrolluar humbjet e transmisionit.

Për momentin, nuk është e mundur për të identifikuar cilat shpenzime shtesë janë bërë për shkak të gabimeve në parashikim e cilat për shkak të pamundësisë të KOSTT-it për të kontrolluar humbjet. ZRRE megjithatë , propozon që të bashkëngjisë një lehtësim prej €0.5 milion (rreth gjysma e asaj që kërkohet nga KOSTT-i) për kompensim të shpenzimeve shtesë të humbjeve në të hyrat e lejuara për KOSTT-in për 2008. Kjo duket se përbën një balancë të arsyeshme mes mbrojtjes së KOSTT-it dhe motivimit për kontrollimin e humbjeve. Për 2008, ZRRE ka pranuar humbje të transmisionit prej 3.9%⁷ , gjë që reflekton vlerësimet më të reja të humbjeve aktuale.

5.2 Shpenzimet kapitale të pafinancuara

Në materialin e bashkangjitur KOSTT-i ka supozuar se shpenzimet e kërkuara kapitale prej €38.5 milion në 2008 do të jenë gati tërësisht të financuara nga grantet, gjithsej €38 milion. Prej këtij totali, €17.2 milion në grante janë supozuar të ofrohen nga BKK⁸. Kurse €1.6 milion supozohet të jepet nga donatorë të paidentifikuar deri me tani.

BKK i ka aprovuar €15.5 milion në grante për KOSTT-in. Në përputhje me qasjen e saj ndaj shpenzimeve të pafinancuara kapitale për KEK-un, ZRRE më tutje propozon që të reduktojë shpenzimet e lejuara kapitale për KOSTT në 2008 nga diferenca mes granteve të supozuara dhe aktuale të BKK-së. Për më shumë, ZRRE propozon reduktimin e shpenzimeve të lejuara që supozohet të financohen nga burime të paidentifikuara donatorësh bazuar në atë se nuk është reale që KOSTT-i të supozojë se do të jetë në gjendje të marrë dhe shpenzojë këto fonde në 2008.

⁷ Ekuivalent me faktorin e humbjes së transmisionit prej 1.041 siç aplikohet në rregullat e tregut.

⁸ Përfshijimi i projekteve ku BKK pritet të japë një kontribut të pjesërisht në 2008 ose vitet pasuese.

Kërkesa e të hyrave të lejuara – KOSTT

Kjo rezulton në një reduktim total të propozuar të shpenzimeve kapitale të lejuara për KOSTT-in në 2008 prej €3.3 milion. Reduktimi rezultues në të hyrat vjetore të lejuara për 2008 është afërsisht €0.1 milion.⁹

5.3 Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit

Për 2007, ZRRE ka caktuar një mesatare të peshuar të koston së kapitalit (MPKK-kthimi i lejuar mbi asetet) prej 13.8% në kushte nominale për KEK-un dhe KOSTT-in⁹. Në aplikacionin e tij KOSTT-i ka kërkuar që MPKK-u i lejuar të rritet në 15.87%. Kjo rritje rezulton nga rritja e supozuar në koston e borxhit për KOSTT-in dhe në zbritjen e supozuar të nivelit real të pajisjeve (raporti borxh-paanësi) krahasuar me ato që janë aplikuar më parë nga ZRRE.

ZRRE konsideron që nuk ka arsye të fortë për të ndryshuar koston e kapitalit mes KEK-ut dhe KOSTT-it. KEK-u ka konfirmuar që nuk kërkon rritje të MPKK-ut të lejuar për 2008. Duke marrë parasysh këtë ZRRE propozon që të mbajë të njëjtin MPKK edhe për KEK-un edhe për KOSTT-in për 2008. Ndikimi i kësaj në të hyrat e lejuara të KOSTT-it nuk është signifikante, pasi që gati të gjitha shpenzimet kapitale të tij janë supozuar të financohen nga grantet¹⁰.

⁹ I kalkuluar si prodhim i një MPKKu real (duke përjashtuar inflacionin) prej 10.8% dhe një shkalle të supozuar të inflacionit prej 2.75% në Eurozonë.

¹⁰ KEK-ut dhe KOSTT-it iu lejohet që të fitojnë një kthim mbi asetet që nuk janë financuar nga grantet (amortizimi është fituar në të gjitha asetet e reja).

6 Kërkesë për të hyrat e lejuara-propozimet

Tabela 3, në vijim tregon te hyrat totale të lejuara për KEK-un dhe KOSTT-in në 2008, nëse përshtaten më propozimet e ZRRE-së të përshkruara më lart. Rezultati është një reduktim i vogël në të hyrat e lejuara të supozuara nga nivelet e kërkuara nga KEK-u dhe KOSTT-i. Sipas propozimeve të ZRRE-së kostoja e mesatare e rregulluar për njësi në 2008 do të jetë për 5.3% më e madhe se nivelet e lejuara më 2007.

Tabela 3: Të hyrat e propozuara nga ZRRE për tu lejuar

		2007	2007	2008	2008
		Të Lejuara	Aktuale	Të kërkuara	Të propozuar nga ZRrE
Kostoja e blerjes së energjisë a)	000 €	46,316.1	51,090.2	54,632.0	54,632.0
KEK miniera	000 €	42,150.8	36,873.7	44,277.8	44,102.4
KEK Gjenerimi	000 €	38,047.5	32,791.0	42,329.0	41,505.8
KEK Distribucimi (duke përjashtuar humbjet e blerjes së energjisë)	000 €	16,843.5	14,272.4	23,366.8	23,197.9
KEK Furnizimi (duke përjashtuar kostot e energjisë)	000 €	6,008.9	2,235.2	3,252.8	3,021.7
KOSTT (duke përjashtuar humbjet e blerjes së energjisë)	000 €	8,635.3	5,536.0	9,988.8	9,427.2
Total të hyrat e lejuara	000 €	158,002.1	142,798.3	177,847.1	175,887.0
Subvencionimet e Importit	000 €	9,872.9	12,915.0	19,800.0	19,800.0
Të hyrat e Eksportit	000 €	2,765.1	12,804.3	1,461.9	1,461.9
Të hyrat nga shitjet për konsumatorët e kualifikuar	000 €	10,329.5	3,400.6	19,692.3	19,552.4
Total të hyrat e lejuara të mbuluara prej konsumatorëve tarifor	000 €	135,034.6	113,678.4	136,892.9	135,072.7
Shitjet për konsumatorët tarifor	GWh	2,699.7	2,170.2	2,486.5	2,564.5
Kostoja mesatare e rregulluar për njësi	€/kWh	5.00	5.24	5.51	5.27

a) Importi + blerja e energjisë nga Ujmani dhe gjeneratorët e lidhur në rrjetin distributiv

Supozimet e ZRRE-së në trendet e energjisë dhe shitjet finale të energjisë elektrike për tu përdorur për qëllim të caktimit të të hyrave të lejuara për 2008 janë treguar në tabelën 4 në vijim.

Tabela 4. Trendet e energjisë të supozuara nga ZRRE

		2007	2007	2008	2008
		Të Lejuara	Aktuale	Të kërkuara	Të propozuar nga ZRrE
Importi	GWh	576.6	642.3	497.0	497.0
<i>Kostoja mesatare (importet e kontraktuara)</i>	<i>€/kWh</i>	<i>7.40</i>	<i>8.37</i>	<i>10.40</i>	<i>10.40</i>
KEK gjenerimi	GWh	3,942.0	4,239.3	4,407.3	4,407.3
<i>kostoja mesatare (duke përfshirë koston e minierave)</i>	<i>€/kWh</i>	<i>2.03</i>	<i>1.64</i>	<i>1.97</i>	<i>1.94</i>
Gjeneratorët e kyçur në transmisionin e Kosovës	GWh	113.0	70.1	76.0	76.0
<i>Kostoja mesatare</i>	<i>€/kWh</i>	<i>2.13</i>	<i>2.74</i>	<i>2.40</i>	<i>2.40</i>
Gjeneratorët e kyçur në rrjetin e distribucionit	GWh	41.3	23.6	28.0	28.0
<i>Kostoja mesatare</i>	<i>€/kWh</i>	<i>3.00</i>	<i>3.97</i>	<i>4.00</i>	<i>4.00</i>
Total furnizimi	GWh	4,672.8	4,975.3	5,008.3	5,008.3
Kostoja mesatare	€/kWh	2.71	2.43	2.82	2.80
Humbjet në transmision	GWh	169.9	266.6	196.1	196.1
		3.7%	5.4%	3.9%	3.9%
<i>të cilat, humbjet e transmisionit në tranzit</i>	<i>GWh</i>	<i>-31.0</i>	<i>-3.2</i>	<i>-31.0</i>	<i>-31.0</i>
Humbjet në Distribucion	GWh	1,382.8	1,941.7	1,560.1	1,482.1
		35.0%	48.1%	4.0%	38.0%
Konsumi vetanak	GWh	0.0	98.9	100.0	100.0
Eksporti	GWh	92.2	378.9	33.0	33.0
Shitjet për konsumatorin e kualifikuar (Feronikeli)	GWh	359.2	122.2	663.6	663.6
Shitjet për konsumatorët 110 kV	GWh	131.6	76.8	146.3	146.3
Shitjet për konsumatorët e lidhur në rrjetin distributiv	GWh	2,568.1	2,093.4	2,340.2	2,418.2
Shitjet totale për konsumatorët tarifor	GWh	2,699.7	2,170.2	2,486.5	2,564.5

Tarifat me pakicë të kërkuara nga KEK-u

7 Tarifat me pakicë të kërkuara nga KEK-u

KEK-u ka propozuar një numër ndryshimesh në strukturën tarifore:

Pagesat e konsumatorëve

- Ngarkesat e konsumatorëve (tarifat mujore fikse) do të rriteshin substancialisht. Gjithashtu ato do të ri balancoheshin nëse konsumatorët më të mëdhenj do të paguanin shuma më të mëdha se konsumatorët më të vegjël në vend të të ketë nivele të ngjashme të tarifave. KEK-u thotë që tarifat ekzistuese i paraqesin më ulët këto shpenzime fikse të konsumatorëve (të shoqëruara më dispozitat e matjes dhe leximit të njehsorëve, faturimit dhe shërbimeve të inkasimit) dhe se ato shpenzime janë shumë më të mëdha për konsumatorët më të mëdhenj (për shkak të kompleksitetit dhe njehsorëve më të shtrenjtë si dhe kërkesave më të mëdha për menaxhimin e llogarive të konsumatorit).

Tarifat ditore

- Tarifat ditore (TD) do të eliminoreshin për konsumatorët e kategorisë së 4-të (kategoria II-0.4kV) dhe 5 (konsumatorët shtëpiak standard). Tarifat sezonale (sezona e ulët dhe lartë) do të mbahen. KEK-u thotë se tarifat ditore është joefektive në menaxhimin e kërkesave, pasi që orët e njehsorëve janë në përgjithësi jo të sakta¹¹ dhe për këtë arsye nuk përfitojnë konsumatorët duke kështu konsumin e tyre në periudhat jashtë pikut (të ulëta) dhe është e hapur mundësia për të abuzuar për shkak të manipulimit me orët e njehsorëve.

Tarifat shtëpiake të bllokut rritës

- Tarifat e bllokut rritës do të eliminoreshin për konsumatorët shtëpiakë nën matje (kategoritë 5 dhe 6). KEK-u thotë që një mbrojtje adekuate për konsumatorët më të varfër mund të ofrohet përmes mirëqenies ekzistuese sociale dhe mekanizmave subvencionues të kombinuar me tarifën e re dy-blokeshe për ata konsumatorë të gatshëm për të demonstruar statusin e tyre të varfër.

KEK-u gjithashtu ka propozuar një numër të masave përmbytëse mbi ndryshimet e strukturave tarifore.

Asnjë tarifë nuk zvogëlohet

- Asnjë nga tarifat nuk duhet të zvogëlohet. Kjo masë përmbytëse është propozuar pasi që KEK-u e ven në pyetje arsyeshmërinë e supozimeve të Modelit të Tarifës me pakicë (MTP) që qon kah zvogëlimi i disa tarifave dhe njëkohësisht tarifa mesatare rritet (shih Pjesën 2). Nëse zvogëlimet në tarifa janë rezultat i supozimeve model që ndryshojnë më vonë atëherë kjo do të krijonte pasiguri për konsumatorët dhe nuk do të përparonte reflektivitetin e kostos së tarifave.

Eliminimi gradual i ndërsbvencioneve

Tarifat për konsumatorët shtëpiak nuk duhet të rriten në nivelin e plotë të reflektivitetit të kostos sepse një veprim i tillë mund të shkaktojë shok të rëndë çmimor për këta konsumatorë. Ndërsbvencionet ende mbetin si faktorë kryesorë .

¹¹ KEK-u atribuon këtë ngarkesë rajonale të shpeshtë e cila çon në ndaljen e orëve të njehsorëve gjatë kohës së ndërprerjes së furnizimit.

Tarifat me pakicë të kërkuara nga KEK-u

Tabela 5 tregon tarifat e kërkuara nga KEK-u krahasuar me ato ekzistuese.

Tabela 5. Tarifat me pakicë të kërkuara nga KEK-u

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Ekzistuese		Propozuar nga ZRRrE për vitin 2008	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		2,743.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		519.00	519.00	520.00	520.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.03	1.78	6.70	2.00
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.50	1.47	3.00	1.75
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.00	0.00	0.00	0.00
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		30.00		352.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		540.00	540.00	540.00	540.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.30	2.73	6.40	2.80
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.33	2.47	3.35	2.51
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.04	0.04	0.00	0.00
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		148.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		466.00	466.00	466.00	466.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.07	3.15	7.90	3.25
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.81	2.87	4.00	2.95
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.32	0.32	0.53	0.53
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		29.00		81.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		270.00	270.00	300.00	300.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.85	4.36	8.00	4.50
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.95	4.11	5.10	4.20
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		1.53	1.53	1.55	1.55
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		76.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		0.00	0.00	0.00	0.00
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	9.68	6.26	8.85	5.95
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	11.64	7.63	11.70	7.90
			€/kWh	Tarifa e ulët	5.82	3.81	6.00	4.00
5	0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00		65.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.42	3.17	5.60	4.10
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.21	1.58	5.60	4.10
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	5.97	4.28	5.60	4.10
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.99	2.14	5.60	4.10
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	8.67	6.21	5.60	4.10
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.33	3.11	5.60	4.10
6	0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00		55.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifa e vetme	3.94	2.82	5.60	4.10
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifa e vetme	5.32	3.81	5.60	4.10
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë)	€/kWh	Tarifa e vetme	7.72	5.53	5.60	4.10
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <200kWh/month	€/konsumator/muaj		20.00		26.00	
		Konsumi i vlerësuar 200-600kWh/month	€/konsumator/muaj		36.00		48.00	
		Konsumi i vlerësuar >600kWh/month	€/konsumator/muaj		61.00		116.00	
8	Ndrëçimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		55.00	
		Energjia Aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e vetme	7.82	7.82	5.43	5.43

8 Shqyrtimi i tarifave të kërkuara

ZRRE ka pasur vështirësi që të kuptojë bazën e disa prej ndryshimeve në tarifën e propozuar nga KEK-u. Diskutimi i përmbajtur në këtë shkrim megjithatë përfaqëson mënyrën e kuptimit të ZRRE-s të propozimeve të KEK-ut.

Përkitazi me ndryshimet në strukturën e propozuar nga KEK-u, ZRRE ka komentet vijuese:

Ngarkesat fikse të konsumatorëve

- ZRRE pajtohet që është mirë që të rriten ngarkesat relative të konsumatorëve që aplikohen për konsumatorët më të mëdhenj dhe që reflektojnë çmimin më të lartë të shërbimit.

Tarifat ditore (TD)

- ZRRE pranon që ka një argument të fortë për eliminimin e TD për konsumatorët e vegjël duke marrë parasysh kufizimet e njehsorëve ekzistues. Megjithatë, ZRRE gjithashtu ka parasysh që KEK-u është angazhuar në një program të prokurimit të njehsorëve të rinj për konsumatorët. Deri sot, ZRRE nuk ka pasur mundësinë që të diskutojë me KEK-un tipet e njehsorëve që do t'u ofrohen konsumatorëve më të vegjël sipas këtij programi. ZRRE beson që është mirë të hetohet se a mund t'i eliminojnë njehsorët e rinj problemet ekzistuese me matjen në mënyrë që të lejohet vazhdimi i aplikimit të një tarife efektive TD për konsumatorët më të vegjël. Një tarifë e tillë ka beneficione të dukshme në motivimin e menaxhimit të kërkesave nga konsumatorët dhe për avancimin e mundësisë paguese për konsumatorët më të varfër.

Tarifat shtëpiake të bllokut rritës

- ZRRE momentalisht nuk beson se është në rregull të eliminohet blloku rritës i tarifave për konsumatorët shtëpiak. Kjo tarifë luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e mundësisë paguese të energjisë për ekonominë e varfra familjare. ZRRE gjithashtu brengoset se implementimi i tarifës alternative të propozuar nga KEK-u për konsumatorët nevojë nuk është real për momentin- kriteret për privilegjet për këtë tarifë mbetet për tu definuar dhe ekziston një periudhë shumë e kufizuar në të cilën ekonominë familjare mund të aplikojnë për tu kyçur në atë tarifë para se të eliminohet blloku rritës ekzistues. ZRRE vëren se tarifën e kërkuar të KEK-ut do të rezultojnë që tarifa e energjisë për konsumatorët shtëpiakë të bllokut të parë (nën 200kWh në muaj) do të rriten në shkallë të madhe.

Tarifat e kërkuara nga KEK-u gjithashtu do të rezultojnë, sipas përlogaritjeve të ZRRE-së, në të hyrave të lejuara për afërsisht €27 milion ose 20% më shumë se të nivelit të lejuar për 2008. Rrjedhimisht do të jetë e nevojshme që të bëhen përshtatjet e duhura për të korrigjuar këtë.

Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRRE

9 Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRRE

Duke marrë parasysh çështjet e mësipërme ZRRE ka përpiluar propozimin e vet preliminar për tarifat me pakicë.

Këto i përfshijnë dy ndryshimet e propozuara për strukturat tarifore:

Pagesat e konsumatorëve

- Duhet të bëhet një ri përshtatje e pagesave fikse të konsumatorit për të reflektuar një kosto relativisht më të lartë për konsumatorët më të mëdhenj. Megjithatë, ZRRE nuk konsideron që rritjet shumë të mëdha në të gjitha ngarkesat fikse të konsumatorëve të propozuara nga KEK-u janë të justifikuar:
- Këto rritje nuk përfaqësojnë përlllogaritjet e ZRRE-së për ngarkesat e konsumatorëve që reflektojnë koston të cilat në fakt janë shumë më të ulëta.
- Rritjet e ngarkesave të konsumatorëve janë regresive dhe mund të kenë ndikim shumë negativ në mundësinë paguese të konsumatorëve të vegjël shtëpiakë. Këta në fakt nuk do të jenë më në gjendje të reduktojnë faturat e tyre të energjisë duke reduktuar konsumin.

Pagesat e energjisë reaktive

- Në pasqyrë, ZRRE konsideron që çmimet e energjisë reaktive për konsumatorët prej 35kV dhe 10kV (kategoria 1 dhe 2) janë shumë të ulëta dhe nuk reflektojnë koston. ZRRE konsideron që këto çmime duhet të jenë të ngjashme me ato të aplikuar për konsumatorët më matje të energjisë reaktive prej 0.4kV (kategoria 3).

Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRRE janë përpiluar si vijon:

- Ngarkesat e konsumatorit për konsumatorët shtëpiakë (kategoria 5 dhe 6) mbasin të pandryshuara. Pagesat e kategorive tjera do të përshtaten ashtu që ngarkesa e konsumatorit e lidhur me atë për konsumatorët shtëpiakë reflekton vlerësimet e KEK-ut për koston relative të shërbimit të kategorive të konsumatorëve¹². Nëse kjo do të rezultonte në një ngarkesë më të vogël të konsumatorit se ajo që aplikohet tash atëherë pagesa e konsumatorit ekzistues mbetet e pandryshuar.
- Tarifat e energjisë reaktive për konsumatorët me 35kV dhe 10kV (kategoria 1 dhe 2) do të rriten për të barazuar ato të aplikuar te konsumatorët me 0.4kV (kategoria 3).

Tarifat tjera janë rritur për 5% në proporcion me rritjen mesatare të kërkuar.

Tarifat rezultuese me pakicë të propozuara nga ZRRE janë paraqitur në vijim.

¹² Psh. KEK- ka llogaritur se kostoja e shërbimit të konsumatorëve – kategoria 1 (35kV) është 5.4 herë më e madhe se kostoja e shërbimit të konsumatorëve shtëpiakë të kategorisë 5. Kjo nënkupton se nëse ngarkesa fikse për konsumatorë është 24€/vit për të fundit, ngarkesa për kategorinë 1 duhet të jetë €129.60/vit.

Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRRE

Tabela 6. Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRRE

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementet tarifore	Njësia	Koha gjatë ditës (a)	Ekzistuese		Propozuar nga ZRrE për vitin 2008	
					Sezona e lartë	Sezona e ulët	Sezona e lartë	Sezona e ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 30 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		981.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		519.00	519.00	545.00	545.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.03	1.78	6.33	1.87
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.50	1.47	2.63	1.54
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.00	0.00	0.00	0.00
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		30.00		130.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		540.00	540.00	567.00	567.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	6.30	2.73	6.62	2.87
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.33	2.47	3.50	2.59
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.04	0.04	1.53	1.53
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		54.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		466.00	466.00	489.00	489.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.07	3.15	7.42	3.31
			€/kWh	Tarifa e ulët	3.81	2.87	4.00	3.01
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		0.32	0.32	1.53	1.53
3	0.4kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		29.00		30.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		270.00	270.00	284.00	284.00
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	7.85	4.36	8.24	4.58
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.95	4.11	5.20	4.32
		Energjia reaktive (Q); c)	€/kVArh		1.53	1.53	1.53	1.53
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		34.00	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		0.00	0.00	0.00	0.00
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifa e vetme	9.68	6.26	10.16	6.57
		Energjia aktive (P), prej të cilës:	€/kWh	Tarifa e lartë	11.64	7.63	12.22	8.01
			€/kWh	Tarifa e ulët	5.82	3.81	6.11	4.00
5	0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00		24.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	4.42	3.17	4.64	3.33
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.21	1.58	2.32	1.66
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	5.97	4.28	6.27	4.49
			€/kWh	Tarifa e ulët	2.99	2.14	3.14	2.25
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit:	€/kWh	Tarifa e lartë	8.67	6.21	9.10	6.52
			€/kWh	Tarifa e ulët	4.33	3.11	4.55	3.27
6	0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		24.00		24.00	
		Energjia aktive (P), për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë)	€/kWh	Tarifa e vetme	3.94	2.82	4.14	2.96
		200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë)	€/kWh	Tarifa e vetme	5.32	3.81	5.59	4.00
		>600 kWh/muaj (Blloku i tretë)	€/kWh	Tarifa e vetme	7.72	5.53	8.11	5.81
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar <200kWh/month	€/konsumator/muaj		20.00		21.00	
		Konsumi i vlerësuar 200-600kWh/month	€/konsumator/muaj		36.00		38.00	
		Konsumi i vlerësuar >600kWh/month	€/konsumator/muaj		61.00		64.00	
8	Ndrëçimi publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/vit		34.00		34.00	
		Energjia Aktive (P), për konsum:	€/kWh	Tarifa e vetme	7.82	7.82	8.21	8.21

10 Pagesat e kërkuara të transmisionit

KOSTT-i nuk ka bërë asnjë kërkesë për ndryshimet në strukturat e pagesave të transmisionit. ZRRE megjithatë ka përllogaritur këto pagesa duke marrë parasysh të hyrat e lejuara të propozuara për 2008. Pagesat rezultuese të transmisionit të propozuara nga ZRRE janë paraqitur në vijim.

Tabela 7. Pagesat e transmisionit të propozuara nga ZRRE

Grupi tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementet tarifore	Njësia	Ekzistuese	Të propozuar nga ZRRE për vitin 2008
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.834	0.855
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.834	0.855
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	0.000	0.000
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.305	0.289
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	3.025	3.629
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.834	0.855
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/MW/vit	6.792	7.901
		Tarifat për operim të sistemit	€/MWh	0.834	0.855
		Tarifat për operim të tregut	€/MWh	0.013	0.013